



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1374 Prot.

Tiranë, më 10.10.2024

URDHËR

Nr. 39, datë 10/10 2024

MBI

“MARRJEN E MASAVE PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
KONKURSEVE TË PRANIMIT RAUNDI III-të
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Organizimi i konkurseve Raundi III për ciklin e parë (Bachelor), në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, të cilat kanë kuota të lira, zhvillohet si më poshtë vijon:

1. Në **datat 11-16 Tetor 2024 ora 08:00-16:00** kandidatët regjistrohen pranë fakulteteve përkatëse në Universitetin e Arteve sipas kuotave të lira të shpallura në U-Albania;

Dokumentacioni për tu regjistruar në konkurset e pranimit është:

- Diplomë e shkollës së mesme dhe lista e notave e printuar nga e-Albania (*me vulë elektronike*), ose Diploma dhe lista e notave e shkollës së mesme (*të noterizuar nëse nuk janë me vulë elektronike*).
 - Mandati i pagesës së tarifës të konkurrimit;
 - Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
 - Dy fotografi.
2. Në **datat 17-18 Tetor 2024** fakultetet e Universitetit të Arteve organizojnë zhvillimin e konkurseve të pranimit;
 3. Në datën **18 Tetor 2024 mbas orës 16:00** kryhet publikimi i listave të fituesve në fakultetet përkatëse dhe në faqen zyrtare të Universiteti të Arteve;



4. Në datën 21-22 Tetor 2024 nga ora 08:00 deri në orën 16:00 kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse të Universitetit të Arteve.
 5. Në datën 23 Tetor 2024 publikohen listat e kandidatëve të regjistruar në ambientet e fakulteteve të UART.
- Sektori i Shërbimeve si dhe Fakultetet në UART të marrin masat e nevojshme për përgatitjen e ambienteve në të cilat do të zhvillohen konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit.
 - Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri çdo strukturë në ndihmë të këtij procesi në UART.
 - Ky Urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

